



ZYRA E PROKURIMIT

Nr 68/2021

Nr. Protokolli: 101/2021

Për:	BAJRAM HA.GASHI B.I., Suharekë, 23000, SUHAREKË
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	02.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës 29.06.2021, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: **BAJRAM HA.GASHI B.I., Suharekë, 23000, SUHAREKË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi dhe meremetimi i shkollave 2 LOT LOT 1- Ndërtimi dhe meremetimi i shkollës në Grejçec dhe Duhël. LOT 2- Rregullimi i ngrohjes qendrore në SHFMU 17 Shkurti Shirokë** me Nr. të Prokurimi: 624-21-2400-5-2-1 & 624-021-085-521 -nxjerr këtë:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës 29.06.2021 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: **BAJRAM HA.GASHI B.I., Suharekë, 23000, SUHAREKË** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi dhe meremetimi i shkollave 2 LOT, LOT 1- Ndërtimi dhe meremetimi i shkollës në Grejçec dhe Duhël, LOT 2- Rregullimi i ngrohjes qendrore në SHFMU 17 Shkurti Shirokë** kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 25.06.2021 të publikuar në platformen elektronike.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 25.06.2021.**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 29.06.2021 , ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Ndërtimi dhe meremetimi i shkollave 2 LOT**

LOT 1- Ndërtimi dhe meremetimi i shkollës në Grejçec dhe Duhël.

LOT 2- Rregullimi i ngrohjes qendrore në SHFMU 17 Shkurti Shirokë me Nr. të Prokurimi: 624-21-2400-5-2-1 & 624-021-085-521 - kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të dates, 25.06.2021.të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe se pretendimet tuaja nuk qendrojnë, ngase ne oferten nga se edhe pas sjelljeve të dëshmime sipas kërkeses per sqarim te tenderit për pozicione jo normalisht të ulta derguar nga Autoriteti Kontraktues me date 21.06.2021 dëshmit e ofruara nuk kanë qenë bindëse për Anëtarët e komisionit vlerësues ,pasi që disa fatura te prezantuara te disa pozicione janë te vitit 2020.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit

Afrim BYTYQI

